



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Këshilli i Fakultetit të Edukimit, në mbledhjen e mbajtur online, në platformën meet.google.com, më 22 prill 2020, ka miratuar vendim për organizimin e praktikës pedagogjike për studentët e vitit të dytë (Programi Fillor dhe Programi Parashkollor), si dhe për vazhdimin e praktikës pedagogjike për studentët e vitit të katër (Programi Fillor dhe Programi Parashkollor).

Po kështu, në këtë mbledhje, është diskutuar edhe dokumenti bazë, sipas të cilit do të organizohet praktika pedagogjike, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen nga ana e profesorëve.

Në këtë mënyrë, për shkak të rrethanave të paraqitura, sikurse në gjithë botën, edhe në Republikën e Kosovës, si pasojë e pandemisë nga COVID-19, Këshilli i Fakultetit të Edukimit, ka miratuar dokumentin

**ORGANIZIMI I PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE GJATË PERIUdhËS SË MËSIMIT VIRTUAL NË UKZ - FAKULTETI I EDUKIMIT, SI PASOJË E SHFAQJES SË COVID- 2019**

**Praktika Pedagogjike IV (PF)- Programi Parashkollor, viti IV**

**Udhëzime specifike**

1. Dokumenti bazë për realizimin e Praktikës Pedagogjike IV është **Doracaku i Mësimi Praktik** për Programin Parashkollor.
2. Bartës dhe vlerësues përfundimtar i lëndës Praktika Pedagogjike IV (PF) është **profesori mbikëqyrës**, i caktuar nga Zyra për Mësim Praktik.
3. **Roli i profesorit mbikëqyrës:**
  - a. Të formojë një **google.classroom** me studentët që i ka në mbikëqyrje. Këtu vendosen kërkesat e lëndës nga ana e profesorit mbikëqyrës, ndërsa studentët ngarkohen me detyrat e kërkuara. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë mund të aplikohet **Elearning** (Moodle) ose Gmail.
  - b. Profesori mbikëqyrës, mbanë takime të rregullta javore me studentët që i ka në mbikëqyrje, përmes të **meet.google**, për aq orë sa i ka të planifikuara me kontratë. Profesori mbikëqyrës, gjatë takimeve në **meet.google**, diskuton me studentët rreth

vrojtimeve, teknikave të vrojtimin, reflektimit mbi vrojtimet, detajet rreth planifikimeve të aktiviteteve mësimore, siç janë metodat, strategjitë, teknikat dhe taktikat e përdorura gjatë realizimit të planifikimit të aktivitetit mësimor dhe sfidat e tjera rreth mësimdhënies/mësimnxënies.

- c. Të kërkojë nga studentët përfundimin e detyrave me të cilat ngarkohen ata dhe t'i përcjellë ato me informata kthyesë.
- d. T'i vlerësojë studentët të cilët i ka në mbikëqyrje, sipas kryerjes së detyrave.

#### 4. Detyrat e studentit:

- a. Studentët do të vrojtojnë dhe reflektojnë në ditarin e studentit për së paku 10 aktivitete, të cilat do t'i gjurmojnë në *youtube* ose faqe edukative në internet ose TV. Fokusi i reflektimit do të jetë në aspekte të ndryshme: psh. Reflektimi 1- fokusohet në ndërveprimin e edukatores me fëmijët, Reflektimi 2 - Në ndërveprimin e fëmijëve midis vete, Reflektimi 3- Në qëllimin e aktivitetit dhe zhvillimin holistik të fëmijëve, Reflektimi 4- Në rregullimin e ambientit dhe klimën në (klasë) grup etj... Reflektimet do të postohen në **google.classroom** dhe do të jenë të hapura vetëm për profesorin mbikëqyrës.
- b. T'i digjitalizojë së paku dhjetë vrojtime dhe reflektime të kryera në tri javët e para të mësimin praktik. Vrojtimet dhe reflektimet të shkruhen në formatin *word* dhe të dërgohen tek profesori mbikëqyrës për vlerësim.
- c. Të krijojë një dosje elektronike të planifikimit të aktiviteteve mësimore, sipas fushave kurrikulare dhe përmes platformës **google.classroom** t'i dërgojë tek profesori mbikëqyrës për vlerësim. Dosja duhet të përmbajë minimum: dy planifikime për çdo fushë kurrikulare (d.m.th. së paku 14 planifikime).
- d. Studentët do të përgatisin shembuj (modele) të një planifikimi vjetor, mujor, javor dhe ditor, për një fushë të caktuar kurrikulare (këto planifikime vendosen në **google classroom**).
- e. Studentët të njihen me instrumente për vlerësimin e fëmijëve për ndonjë fushë të caktuar të zhvillimit, sipas Kornizës Kurrikulare.
- f. Secili student do të prezantojë së paku një video-incizim, duke u bazuar në mësimin *online* organizuar nga MASHTI, duke prezantuar aktivitete (mundësisht të integruara) për fëmijët e moshave 3 deri 6 vjeç dhe këto t'i ndan me kolegët në **google.classroom**. Studentët duhet të komentojnë lidhur me prezantimet e kolegëve të tyre.
- g. Studentëve do t'u vlerësohen 4 javë të praktikës pedagogjike, të realizuara në institucione, gjatë muajve shkurt - mars 2020.

*Vërejtje: Në rast të përmirësimit të gjendjes pandemike dhe kthimit në objektet e universitetit, studentët do të vazhdojnë edhe 2 deri 4 javë të praktikës së drejtpërdrejtë në institucion parashkollor, sipas planifikimit të Zyrës për Mësim Praktik (ZMP).*

### Udhëzime specifike

1. Dokumenti bazë për realizimin e Praktikës Pedagogjike IV është **Doracaku i Mësimi Praktik** për Programin Parashkollor.
2. Bartës dhe vlerësues përfundimtar i lëndës Praktika Pedagogjike IV (F) është **profesori mbikëqyrës**, i caktuar nga Zyra për Mësim Praktik.

### 3. Roli i Profesorit mbikëqyrës:

- a. Të formojë një **google.classroom** me studentët që i ka në mbikëqyrje. Këtu vendosen kërkesat e lëndës nga ana e profesorit mbikëqyrës, ndërsa studentët i ngarkojnë detyrat e kërkuara. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë mund të aplikohet **Elearning** (Moodle) ose Gmail.
- b. Profesori mbikëqyrës, mbanë takime të rregullta javore me studentët që i ka në mbikëqyrje, përmes të **meet.google**, për aq orë sa i ka të planifikuara me kontratë. Profesori mbikëqyrës, gjatë takimeve në **meet.google**, diskuton me studentët rreth vrojtimeve, teknikave të vrojtimet, reflektimit mbi vrojtimet, detajet rreth planifikimeve të aktiviteteve mësimore, siç janë metodat, strategjitë, teknikat dhe taktikat e përdorura gjatë realizimit të planifikimit të aktivitetit mësimor dhe sfidat e tjera rreth mësimdhënies/mësimnxënies.
- c. Të kërkojë nga studentët përfundimin e detyrave me të cilat ngarkohen ata dhe t'i përcjellë ato me informata kthyesë.
- d. T'i vlerësojë studentët të cilët i ka në mbikëqyrje sipas kryerjes së detyrave.

### 4. Detyrat e studentit:

- a. Studentët do të vrojtojnë dhe reflektojnë në ditarin e studentit për së paku 10 aktivitete, të cilat do t'i gjurmojnë në *youtube* ose faqe edukative në internet ose TV. Fokusi i reflektimit do të jetë në aspekte të ndryshme: psh. Reflektimi 1- fokusohet në ndërveprimin e mësuesit me nxënësit, Reflektimi 2- Në ndërveprimin e nxënësve ndërmjet tyre, Reflektimi 3- në qëllimin e aktivitetit dhe zhvillimin holistik të nxënësve, Reflektimi 4- në rregullimin e ambientit dhe klimën në (klasë) grup etj... Reflektimet do të postohen në **google.classroom** dhe do të jenë të hapur vetëm për profesorin mbikëqyrës.
- b. T'i digjitalizojë së paku dhjetë vrojtime dhe reflektime të kryera në tri javët e para të mësimi praktik. Vrojtimet dhe reflektimet të shkruhen në formatin *word* dhe të dërgohen tek profesori mbikëqyrës për vlerësim.
- c. Të krijojë një dosje elektronike të planifikimeve të aktiviteteve mësimore, sipas fushave kurrikulare dhe përmes platformës **google.classroom** t'i dërgojë tek profesori mbikëqyrës për vlerësim. Dosja duhet të përmbajë minimum: dy planifikime për çdo fushë kurrikulare (d.m.th. së paku 14 planifikime).
- d. Studentët do të përgatisin shembuj (modele) të një planifikim vjetor, dymujor, javor dhe ditor, për një fushë të caktuar kurrikulare (këto planifikime vendosen në

**google.classroom**).

- e. Studentët të njihen me instrumente për vlerësimin e nxënësve për ndonjë fushë të caktuar të zhvillimit, sipas Kornizës Kurrikulare.
- f. Secili student do të prezantojë së paku një video-incizim, duke u bazuar në mësimin *online* organizuar nga MASHTI, duke prezantuar aktivitete (mundësisht të integruara) për nxënësit e shkollës fillore dhe këto t'i ndajë me kolegët në **google.classroom**. Studentët duhet të komentojnë lidhur me prezantimet e kolegëve të tyre.
- g. Studentëve do t'u vlerësohen 4 javë të praktikës pedagogjike, të realizuara në institucione, gjatë muajve shkurt - mars 2020.

*Vërejtje: Në rast të përmirësimit të gjendjes pandemike dhe kthimit në objektet e universitetit, studentët do të vazhdojnë edhe 2 deri 4 javë të praktikës së drejtpërdrejtë në shkollat fillore, sipas planifikimit të Zyrës për Mësim Praktik (ZMP).*

## Praktika Pedagogjike II (PF)

### Programi Parashkollor, viti II

1. Dokumenti bazë për realizimin e Praktikës Pedagogjike II është **Doracakun e Mëimit Praktik** për Programin Parashkollor.
2. Bartës i lëndës dhe përgjegjës për vlerësimin përfundimtar për lëndën **Praktika Pedagogjike II (PF)** dhe vendosjen e notës në SMU është Profesori i lëndës. Në vlerësimin përfundimtar të lëndës Praktikë Pedagogjike II (PF), profesori i lëndës, për secilin student, duhet ta përfshijë pjesën e vlerësimit të profesorit mbikëqyrës, në vlerën 50 %.
3. Sipas akreditimit të programit, studentët i kalojnë 4 javë në Mësim Praktik. Profesorët mbikëqyrës për grupe të studentëve caktohen nga Zyra për Mësim Praktik.
4. **Roli dhe detyrat e Profesorit mbikëqyrës:**
  - a. Të formojë grupin, në **google.classroom**, sipas ndarjes së studentëve nga Zyra e Mëimit Praktik dhe t'i mbajë takimet me studentë në **google.meet**. Numri i orëve të mbajtura gjatë javës duhet të jetë në pajtim me angazhimin që e ka profesori me studentët sipas orarit mësimor.
  - b. Të kërkojë nga studentët përfundimin e detyrave të përcaktuara dhe t'i përcjellë ato me informata kthyesë.
  - c. Të vlerësojë të gjithë studentët sipas punës së tyre.
5. **Detyrat e studentit:**
  - a. Studentët, rregullisht, për katër javë, të ndjekin aktivitetet online për fëmijët 3-6 vjeç, sipas MASHTI.
  - b. Studentët do të vrojtojnë dhe reflektojnë për çështje me rëndësi bazuar në pasqyrën e programit të paraqitur në doracakun e Mëimit Praktik. Aktivitetet vrojtuese dhe reflektuese do të fokusohen në aspektet të cilat i përcakton profesori mbikëqyrës,

bazuar në Doracakun e Mësimiit Praktik. Studentët duhet të realizojë së paku dhjetë vrojtime të aktiviteteve mësimore – online dhe të reflektimet mbi ato aktivitete. Vrojtmet dhe reflektimet të shkruhen në formatin *word* dhe të dërgohen te profesori mbikëqyrës. Dërgimi i materialeve te profesori mbikëqyrës është e kërkuar të bëhet përmes të **google.classroom**. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë aplikohet Elearning (Moodle) ose Gmail.

- c. Studentët do të marrin pjesë aktive në takimet organizuara nga profesori mbikëqyrës, në platformën **meet.google**.
- d. Studentët angazhohen të përgatisin *portfolion profesionale* (fizike dhe elektronike), sipas kërkesave të Doracakut të Mësimiit Praktik.
- e. Secili student do të prezantojë së paku një video-incizim, duke u bazuar në mësimin *online* organizuar nga MASHTI, duke prezantuar aktivitete (mundësisht të integruara) për fëmijët e moshave 3 deri 6 vjeç dhe këto t'i ndan me kolegët në **google.classroom**. Studentët duhet të komentojnë lidhur me prezantimet e kolegëve të tyre.
- f. Provimi përfundimtar nga lënda Praktika Pedagogjike II (PF), paraqitet te profesori i lëndës, tek i cili i ka dëgjuar ligjëratat.

Vërejtje: Sipas planifikimit të Zyrës për Mësimin Praktik, studentët do të angazhohen me mësim praktik, gjatë periudhës 27 prill 2020 – 22 maj 2020. Prandaj, duhet t'iu sigurohet mundësia që në rast të kthimit në objektet e universitetit, studentët të vijojnë praktikën, sipas javëve të planifikuara.

## Praktika Pedagogjike II (F) - Programi Fillor, viti II

### Udhëzime specifike

1. Dokumenti bazë për realizimin e Praktikës Pedagogjike II (F) është **Doracaku i Mësimiit Praktik** për Programin Fillor.
2. Bartës i lëndës dhe përgjegjës për vlerësimin përfundimtar për lëndën **Praktika Pedagogjike II (F)** dhe vendosjen e notës në SMU është Profesori i lëndës. Në vlerësimin përfundimtar të lëndës Praktika Pedagogjike II (F), profesori i lëndës, për secilin student, duhet ta përfshijë pjesën e vlerësimit të Profesorit mbikëqyrës, në vlerën 50 %.
3. Sipas akreditimit të programit, studentët i kalojnë 4 javë në Mësim Praktik. Profesorët mbikëqyrës për grupe të studentëve caktohen nga Zyra për Mësim Praktik.
4. **Roli dhe detyrat e Profesorit mbikëqyrës:**
  - a. Të formojë grupin, në **google.classroom**, sipas ndarjes së studentëve nga Zyra e Mësimiit Praktik dhe t'i mbaj takimet me studentë në **google.meet**. Numri i orëve të mbajtura gjatë javës duhet të jetë në pajtim me angazhimin që e ka profesori me studentët sipas orarit mësimor.
  - b. Të kërkojë nga studentët përfundimin e detyrave të përcaktuara dhe t'i përcjellë ato me informata kthyesë.
  - c. Të vlerësojë të gjithë studentët sipas punës së tyre.

## 5. Detyrat e studentit:

- a. Studentët rregullisht, për katër javë, të ndjekin mësimin online, të ofruar nga MASHTI.
- b. Studentët do të vrojtojnë dhe reflektojnë për çështje me rëndësi bazuar në pasqyrën e programit të paraqitur në doracakun e Mësimit Praktik. Aktivitetet vrojtuese dhe reflektuese do të fokusohen në aspektet të cilat i përcakton profesori mbikëqyrës, bazuar në Doracakun e Mësimit Praktik. Studentët duhet të realizojë së paku dhjetë vrojttime të orëve mësimore – online dhe të reflektimet mbi ato orë. Vrojtimet dhe reflektimet të shkruhen në formatin word dhe të dërgohen te profesori mbikëqyrës. Dërgimi i materialeve te profesori mbikëqyrës është e kërkuar të bëhet përmes të **google.classroom**. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë aplikohet Elearning (Moodle) ose Gmail.
- c. Studentët do të marrin pjesë aktive në takimet organizuara nga Profesori mbikëqyrës, në platformën **meet.google**.
- d. Studentët angazhohen të përgatisin *portfolion profesionale* (fizike dhe elektronike), sipas kërkesave të Doracakut të Mësimit Praktik.
- e. Secili student do të prezantojë së paku një video-incizim, duke u bazuar në mësimin *online* organizuar nga MASHTI, duke prezantuar aktivitete (mundësisht të integruara) për nxënësit e shkollës fillore dhe këto t'i ndajë me kolegët në **google.classroom**. Studentët duhet të komentojnë lidhur me prezantimet e kolegëve të tyre.
- f. Provimi përfundimtar nga lënda Praktika Pedagogjike II (F), paraqitet te profesori i lëndës.

*Vërejtje: Sipas planifikimit të Zyrës për Mësimin Praktik, studentët do të angazhohen me mësim praktik, gjatë periudhës 27 prill 2020 – 22 maj 2020. Prandaj, duhet t'iu sigurohet mundësia që në rast të kthimit në objektet e universitetit, studentët të vijojnë praktikën, sipas javëve të planifikuara.*

22 prill 2020

Prof. Ass. Dr. Merxhan Avdyli  
Dekan